



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.101/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Ramush Bardiqi dhe Kujtim Pasuli, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kandidates (Dorentina Gela) Komuna Vushtrri, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 06.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.101/2025 e datës 03.10.2025.
- II. Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, Zgjedhjet Lokale 2025 që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 800 (tetëqind) euro.
- III. Detyrohet Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.
- IV. Urdhërohet Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ta largojë posterin e vendosur në rrugën “Mbretëresha Teutë”, në Vushtrri, përndryshe mosbindja ndaj kësaj urdhërese paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

Arsyetim

Me datë 03.10.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën theksohet se më datë 02.10.2025, rreth orës 19:00, në rrugën “Mbretëresha Teutë”, në Vushtrri, është evidentuar vendosja e posterëve zgjedhorë të kandidatës për asamble komunale nga radhët e PDK-së, znj. Dorentina Gela, në lamposte publikë. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, sipas të cilit ndalohet vendosja e materialeve zgjedhore në apo mbi hapësirat publike të tilla si rrugët dhe infrastrukturën publike, si dhe me nenin 7 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, që ndalon vendosjen e materialeve në struktura publike si shtylla lamposte.

Vendosja e materialeve zgjedhore në hapësira publike të ndaluara, përveç që bie ndesh me dispozitat e sipërpërmendura ligjore, cenon barazinë e subjekteve politike në garë dhe përbën shfrytëzim të kundërligjshëm të hapësirave të përbashkëta publike.

Në këtë rast, në bazë të pretendimeve të elaboruara në këtë ankesë dhe duke marrë parasysh shkeljen e rregullave zgjedhore nga ana e kandidatës të PDK-së, PZAP-it i kërkojnë që të konstatojë shkeljen e bërë nga Partia Demokratike e Kosovës dhe kandidatja e saj znj. Dorentina Gela, si dhe të ndërmarrë masat e parapara ligjore, duke përfshirë urdhrin për largimin e menjëhershëm të materialeve të vendosura në kundërshtim me ligjin dhe shqiptimin e sanksioneve administrative të përcaktuara. Si provë ka bashkangjitur një kopje të fotografisë.

Në përgjigje në ankesë Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka theksuar se, ka shpërndarë udhëzime të qarta dhe të detajuara për të gjithë anëtarët e saj, duke theksuar rëndësinë e respektimit të ligjit për Zgjedhjet Lokale, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Kodin e Mirësjelljes. Duke shtuar se, Poster i kandidatës Dorentina Gela nuk është vendosur në hapësirë publike, por tërësisht në pronë private, në pompën e benzinës. Si dëshmi, me këtë përgjigje si provë ka bashkëngjitur Certifikatën e pronës, Njësia Kadastrale, nr. P-70202016-01395-1 e datës 25.01.2024 ku është vendosur poster i, prandaj nuk ka shkelje të ligjit. Ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi bindëse se poster i është vendosur në hapësirë publike, përveç një fotografie të errët, e cila nuk dëshmon asgjë dhe nuk tregon vendin e saktë ku ndodhet. Andaj bazuar në nenin 118 (vendimet), par.1 të LZP-së, PZAPI-it i propozojmë që të refuzon ankesën si e pabazuar dhe të konstatohet se ankuesi nuk arritur që të argumentoj përgjegjësinë e PDK-së mbështetur në dëshmi të qarta dhe bindëse.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, ka gjetur se nga provat materiale e bashkangjitur ankesës, të Subjektit Politik LVV, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka

vlerësuar se kandidatja për asamble komunale nga radha e Partisë Demokratike të Kosovës, përkatësisht Dorentina Gela ka vendosur posterë zgjedhorë në rrugët “Mbretëresha Teutë”, Vushtrri duke shfrytëzuar hapësirën publike për promovimin e kandidaturës së saj.

Bazuar në këtë e njëjta ka shkelur Rregulla Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që janë shfrytëzuar hapësirat publike për qëllime elektorale, veprime këto të cilat bien në kundërshtim me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 2 Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decitive parashihet që: *“vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.”*

Sipas vlerësimit të panelit subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, përkatësisht kandidatja për asamble komunale Dorentina Gela ka shfrytëzuar hapësirat publike gjatë fushatës zgjedhore me qëllim të përfitimit të votave. Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimi i kandidates bien ndesh me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1.2 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregullës zgjedhore nr.07/2024.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim, natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes. Kjo konsiston në atë se subjekti politik PDK ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore.

Paneli vlerëson se në rastin konkret kandidates Dorentina Gela, nga Partia Demokratike e Kosovës, urdhërohet që nga momenti i marrjes së këtij vendimi të largojë posterin e vendosur në rrugën “Mbretëresha Teutë”, Vushtrri, ndërsa dështimi për t’iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

Paneli ka vlerësuar edhe përgjigjen në ankesën të Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, mirëpo e njëjta nuk kishte ndikim për vendosje ndryshe nga ajo siç është vendosur në dispozitiv të këtij vendimi, sepse e njëjta nuk e ka kontestuar vendosjen e posterit, duke pretenduar se posterit i kandidates nuk është vendosur në hapësirat publike por i njëjti është vendosur në pronë private. Nga interpretimi i dispozitës së nenit 34 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vlerëson se, edhe nëse vendosja e materialit reklamues-posterit ka qenë i vendosur në pronë private siç ka pretenduar Subjekti Politik, i njëjti nuk ka ofruar provë që subjekti politik ka pasur leje nga pronari i pronës private, për vendosjen e materialit reklamues - posterave.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 33 par. 5, nenit 34 par.1 pika 1.3, nenit 34 paragrafi 1.2 neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-

228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.101/2025 më datën 06.10.2025

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.